

TË HUMBASËSH KUPTIMIN E JETËS

Kërkimi për kuptimin e jetës ka kohë që i ka shqetësuar njerëzit. Shumë poetë dhe filozofë janë përpjekur më kot të zbulojnë «kuptimin» e jetës. Ata nuk kanë qenë më të suksesshëm se sa miliona njerëz të tjerë që janë përpjekur dhe përpiqen të shpjegojnë kuptimin e jetës duke mos e përfillur Perëndinë. Viti i shënuar 1960 (flitet për Amerikën) e përforcoi akoma edhe më shumë këtë ide. Ide nga më të ndryshmet iu sugjeruan njerëzve të pafajshëm si metoda për të zbuluar kuptimin dhe qëllimin e jetës. Shumë njerëz iu bashkangjitën grupeve që përpiqeshin ta gjenin «kuptimin» e jetës në mënyra nga më absurdet (si për shembull sipas veshjeve, filozofive apo muzikës). Disa të tjerë i kthyen sytë nga droga dhe kjo përpjekje për të gjetur kuptimin e jetës vetëm sa e shtoi trishtimin e tyre të madh. Këto përpjekje të kota në kërkim të kuptimit të jetës paraqesin një dështim tjetër tragjik të ateizmit, këto janë përpjekje që të udhëheqin vetëm drejt një jete të paqëllimshme dhe pa kuptim! Ateizmi nuk mund të na tregojë kuptimin e jetës, sepse ai e ka mohuar Perëndinë, në të cilin qëndron vetë kuptimi i jetës. Me pak fjalë, ateizmi ofron një pikëpamje për jetën që rezulton vetëm në monotonë, dëshpërim dhe në zbrazëti!

Pakuptueshmëria tragjike e ateizmit shprehet në poemën e fundit të Lordit Bajron, të shkruar tre muaj përpara vdekjes së tij. Poema titullohet «Në këtë ditë u bëra 36 vjeç». Dedikimi i tij ndaj ideve ateiste bëri që në moshë të re ai të jetonte një jetë të

dëshpëruar. Më poshtë janë fjalët dekurajuese të tij:

Ditët e mia janë si gjetet e fishkura,
Lulet dhe frutet e dashurisë kanë mbaruar,
Krimbat, plagët dhe trishtimi
Janë gjithë çfarë më kanë mbetur!

Njerëzit nuk kanë pse të provojnë të njëjtin fat që provoi Bajroni apo shumë njerëz të tjerë në ditët tona. Ka një alternativë tjetër që i jep kuptim jetës dhe e bën atë të gëzuar, plot me kënaqësi dhe shpërblime. Kjo alternativë vjen nga besimi se Perëndia i qiellit ekziston. Kjo jetë bëhet me besim të plotë në ekzistencën e të Plotfuqishmit, në sovranitetin dhe në dashurinë e Tij.

Shikoni me vëmendje këto dy ide kur kërkoni të gjeni kuptimin e jetës. Njerëzit që janë të arsyeshëm menjëherë do të dallojnë boshësinë e ateizmit dhe shpresën që ofron besimi në Perëndi.

ATEIZMI, KJO FILOZOFI E PAVLERË!

E para, na thuhet, nga shumë burime sot, se për të gjetur kuptimin e jetës duhet të ndryshojmë zakonet tona! Thënia e vjetër na këshillon: «Në qoftë se jeta ju jep një limon, bëjeni atë limonadë!» Kjo është receta që na ofrohet nga ateizmi. Kjo recetë na sugjeron se me anë të procesit të të menduarit ne mund të ndryshojmë çdo gjë të padëshirueshme në jetën tonë. Na tregohet se mënyra se si ne i shikojmë gjërat mund të na çlirojë nga të këqijat e jetës. Por ka një problem të madh me këtë

këshillë, ndryshimi i zakoneve tona nuk i përgjigjet pyetjes: «Pse jemi këtu?» Ndryshimi i sjelljes nuk zëvendëson jetën e pashpresë me një jetë të mbushur me shpresë. Monotonia dhe mungesa e kuptimit për jetën mbeten të njëjta, pavarësisht se sa të suksesshëm jemi në lënien mënjane të kësaj pyetjeje kaq thelbësore! Njeriu, për t'i dhënë kuptim jetës, ka nevojë për më shumë se sa të ndryshojë sjelljen dhe zakonet e tij. Për të rregulluar jetën tonë ne kemi nevojë për më shumë se sa një ndryshim i thjeshtë.

E dyta, shpesh thuhet se është mirë që të shmangim pyetjet për kuptimin e jetës. Ateizmi thotë se «kuptimi» i vërtetë i jetës është i ndryshëm në njerëz të ndryshëm dhe se nuk mund të matet në mënyrë objektive. Atëherë si është e mundur që ateistët bien dakord me faktin se disa jetë nuk janë «të vlefshme» (për shembull, ata të lindur me sëmundje, të moshuarit, ata që s'mund të kurohen)? Si mund ta pranojë ateizmi se disa jetë janë «të vlefshme» për t'u jetuar ndërkaq që disa të tjera janë «të pavlefshme», në qoftë se ne s'mund të kërkojmë për kuptimin e saj?

Pra, lënia mënjane e kësaj çështjeje nuk i jep kuptim apo vlerë jetës. Po të lëmë mënjane çështjen e kuptimit për jetën, ne i konsiderojmë njerëzit si robotë që nuk mendojnë. Ravi Zacharias foli për absurditetin e një përpjekjeje të tillë: «Njeriu është i huaj për veten e tij. Ai nuk e di se nga vjen apo se ku shkon. Ai kthehet në atome të shpërbëra në një vend me baltë, të pllakosur nga vdekja. Çfarë tallje e fatit.» Një dëshpërim akoma edhe më i madh vjen kur përpiqesh t'i përgjigjesh pyetjes për kuptimin e jetës duke e anashkaluar atë!

E treta, disa njerëz mendojnë se për t'i dhënë kuptim jetës duhet të bësh sa më shumë qejfe. Na thuhet se ilaçi për të shëruar gjithë vuajtjet, mungesën e kuptimit për jetën, mërziqjen dhe zemërimin është kënaqësia, por kjo nuk është zgjidhja e drejtë. Disa njerëz e kthejnë në «aheng» jetën e tyre dhe në fund përsëri mbeten të zbrazur përbrenda. Kënaqësia, në vetvete, s'mund të na çlirojë nga dëshpërimi i jetës së pakuptimë. Teknika e sotme ka krijuar gjithë avantazhet për ta bërë jetën e njerëzve sa më të kënaqshme dhe sa më të lehtë. Në ditët e sotme, punët janë të lehta, arrijtjet mjeksore janë shumë të mëdha dhe zbavitjet janë të larmishme. Njeriu sot ka më shumë mundësi se kurrë që ta shijojë jetën dhe të mirat e saj. Mendoni pak sa shumë ka ndryshuar sasia dhe cilësia e ushqimeve

që sot shqiptarët kanë në tryezat e tyre e krahasuar vetëm me dhjetë vjet më parë. Po ashtu mendoni për lirinë e fjalës dhe të lëvizjes (megjithëse ka shumë vend për përmirësim). Logjika na thotë se njerëzit që jetojnë në këtë kohë do të jenë njerëzit më të kënaqur se njerëzit e të gjitha civilizimeve, por, madje edhe pse sot kemi avantazhe të mrekullueshme, ne prapë zotërohemi nga vetmia paralizuese, nga frika e tmerrshme dhe nga zbrazëtia dekurajuese. Pra, shumë njerëz vuajnë sepse jetojnë një jetë pakuptimë! Pse? Kur ne vazhdimisht u drejtohem qejfeve dhe kënaqësive për të gjetur kuptimin e jetës tonë si dhe përgjigjet e problemeve tona dhe si rezultat ato s'na i ofrojnë këto përgjigje, atëherë zbrazëtia që provojmë është e tmerrshme. Ndërkaq ateizmi na këshillon se sa herë që bëjmë qejfe, aq herë ne do të gjejmë kuptimin për jetën, por realiteti tragjik është se kuptimi i jetës kurrë nuk arrihet përmes qejfeve.

E katërta, shoqëria jonë thotë se përmes suksesit ne do të gjejmë kuptimin e jetës. Na thuhet se, pasi të kemi «arritur» suksesin, atëherë jeta jonë do të ketë kuptim. Kjo është një gënjeshtër tjetër e ateizmit. Ka me miliona dëshmitarë që dëshmojnë faktin se sukcesi në biznes, në pasuri, në famë dhe në lavdi nuk e sjell kuptimin për jetën. Një ilustrim i suksesshëm i këtij fakti paraqitet te filmi me famë *Karrocat e Zjarrit*, i cili përshkruan ekipin olimpiq anglez të atletikës në 1924. Dy burra, Eric Liddle dhe H.S. Abrahams, na japin një kontrast të shkëlqyer. Eric, që më vonë shkoi si misionar në Kinë, kishte një kuptim dhe qëllim për jetën. Ai vraponte për t'i sjellë lavdi Perëndisë. Në anën tjetër, Abrahams, nuk kishte ndonjë qëllim apo kuptim për jetën. Atë vazhdimisht e shqetësonte pyetja për ekzistencën. Në film, pikërisht përpara se të fitonte medaljen e artë, ai tha: «Unë kam dhjetë sekonda për të vërtetuar arsyen e ekzistencës time, por madje edhe gjatë kësaj kohe, nuk jam i sigurt se do të arrij ta gjej atë.» Ai e fitoi medaljen e artë. Ai u bë «njeriu më i shpejtë i botës», por, pavarësisht nga kjo, qëllimi i tij për jetën nuk u bë më i qartë!

Hollywood dhe Wall Street janë të mbushur me shembuj që tregojnë se sukcesi në vetvete nuk sjell kuptim për jetën. Pra, përsëri ateizmi nuk është në gjendje t'u përgjigjet pyetjeve të rëndësishme.

Ateizmi thotë se kuptimi i jetës mund të gjendet po të ndryshojmë zakonet, po të bëjmë qejfe apo po të kemi sukses. Por, në të kundërt, këto gjëra vetëm

sa sjellin akoma edhe më shumë boshësi në jetë! Kuptimi dhe qëllimi për jetën nuk mund të arrihen përmes këtyre alternativave të pashpresa. Shoqëria jonë lëviz pa një qëllim në jetë, ajo akoma edhe më shumë po fundoset në dëshpërim, si rrjedhim i alternativës ateiste që ka zgjedhur.

ZGJEDHJA E VËRTETË, PERËNDIA!

Ne duhet të jemi mirënjohës që alternativa e pavlerë e ateizmit nuk është e vetmja alternativë për të shpjeguar kuptimin e jetës. Besimi në Perëndi na ofron kuptimin dhe qëllimin e vërtetë për jetën. Libri i Predikuesit përmban pyetjen për kuptimin e jetës.

Libri i Predikuesve është një libër rreth jetës, i shkruar nga një neri me «këmbë në tokë». Solomoni, autori i librit, diskuton gjithë aspektet e jetës, në përpjekje për të shpjeguar qëllimin dhe kuptimin e saj. Gjatë gjithë librit shikojmë diskutime rreth problemeve të jetës, suksesit të shkurtër, problemeve seksuale, punëve, drejtësisë, miqve, fesë, gëzimit, vuajtjes dhe kotësisë. Aty na tregohet se disa njerëz nuk do ta gjejnë kuptimin e jetës, dhe do të bëhen cinikë. Të tjerët do ta konsiderojnë jetën të mrekullueshme dhe do ta jetojnë atë plot me gëzim. Cili është ndryshimi midis këtyre dy grupeve? Si është e mundur që njerëzit e shikojnë kuptimin e jetës kaq ndryshe? Ndryshimi është në mënyrën si e shikojnë Perëndinë. Ata që besojnë në Perëndi janë krejt të ndryshëm nga ata që e mohojnë ekzistencën e Tij. Ky ndryshim është në mënyrë të veçantë i dukshëm kur të dy grupet përpiqen të gjejnë kuptimin e jetës.

Ata që e mohojnë Perëndinë e konsiderojnë jetën të pakuptimtë. Ata jetojnë vetëm për vete dhe kurrë nuk gjejnë kënaqësi. Solomoni e përshkroi këtë grup në mënyrë tragjike te Libri i Predikuesit. (1) Ata u ankuan për kotësinë që i rrethonte: «Kotësi e kotësive, gjithçka është kotësi» (1:3). Ata nuk gjenin asnjë kuptim për jetën, por veçse dëshpërim. (2) Ata nuk mundën që të gjejnë kuptimin e jetës përmes suksesit. Në kapitullin e dytë të këtij libri, vargjet 1–11, Solomoni e përshkruan suksesin si të kotë. Ai kishte gjithçka: «Tërë ato që sytë e mi dëshironin, nuk ua mohova atyre; nuk i refuzova zemrës sime asnjë qejf» (2:10). Pasi i kishte plotësuar gjithë dëshirat e tij dhe pasi suksesi i tij e kishte sjellë në majën e famës, Solomoni tha: «Pastaj u ktheva të shikoj tërë veprat që kishin bërë duart e mia dhe mundin tim për t'i kryer; dhe ja, të gjitha

ishin kotësi dhe një kërkim për të kapur erën; nuk kishte asnjë përfitim nën diell» (2:11). (3) Ata që mohojnë Perëndinë përpiqen që të gjejnë kuptimin e jetës përmes zgjuarsisë dhe njohurisë, por ata prapë s'arrijnë ta gjejnë (2:12–17). Pasi Solomoni provoi kotësinë e materializmit, ai u përpoq të gjente kuptim përmes zgjuarësisë (2:12). Por edhe kjo s'dha rezultat për të. «Prandaj fillova të urrej jetën, sepse të gjitha ato që bëhen nën diell më janë bërë të neveritshme, sepse të gjitha janë kotësi dhe një përpjekje për të kapur erën» (2:17). (4) Të gjithë ata që kanë mohuar Perëndinë i pret shkatërrimi i plotë drejt një jete të pakuptimtë. «Kështu arrita të dëshpërohem në zemrën time për gjithë mundin që kam bërë nën diell» (2:20, 5:15).

Në këtë mënyrë i përshkruan libri i Predikuesve ata që jetojnë sipas mësimave të ateizmit. Ata nuk do të gjejnë ndonjë kënaqësi në jetë dhe nuk do të kenë ndonjë shpresë kur t'u vijë vdekja. Ekzistenca e tyre do të jetë e pakuptimtë. S'ka dyshim pse Solomoni në mënyrë të qartë e quajti atë lloj jete «kotësi»!

Libri i Predikuesve thotë se jeta ka kuptim dhe ky kuptim arrihet vetëm kur besojmë në Perëndi. Ky lajm i gëzueshëm jepet te 12:13: «Të dëgjojmë, pra, përfundimin e gjithë ligjëratës: “Ki frikë nga Perëndia dhe respekto urdhërimet e tij, sepse kjo është tërësia e njeriut.”» Në këtë mënyrë, Solomoni po thotë se frika ndaj Perëndisë dhe respektimi i vullnetit të Tij «është ajo që e bën njeriun të plotë, të tërë apo të gjithin». Asnjë nuk është i plotë pa një marrëdhënie të drejtë me Perëndinë. Kjo marrëdhënie realizohet vetëm duke patur frikë nga Perëndia dhe duke përmbushur urdhëresat e Tij.

Sipas librit të Predikuesve, në qoftë se jetoni pa Perëndinë, atëherë jeta nuk ka vlerë për t'u jetuar! Jeta pa Perëndinë është e mbushur me mërzi, me «zgjuarësi» të kotë, me inat për të ardhmen dhe me vdekje të sigurtë! Ata që e jetojnë jetën me Perëndinë zbulojnë një fund krejt të ndryshëm. Jeta me frikë dhe me bindje ndaj Perëndisë e bën jetën njerëzore shumë të vlefshme dhe të pasur (2:24–25, 3:12–13, 22, 5:18–19, 8:15, 9:7–9, 11:9). Çelësi për të gjetur kuptimin dhe qëllimin e jetës është të kesh «frikë nga Perëndia dhe të zbatosh urdhërimet e Tij» (Predikuesve 12:13). Kërkimi i Solomonit tregoi se ky është «përfundimi». Nuk ka ndonjë përgjigje tjetër.

Libri i Predikuesit përmban një fakt shumë të

rëndësishëm. Faktet e bëjnë më të dukshme kotësinë e filozofisë ateiste dhe shtojnë gëzimin e atyre që i binden dhe i besojnë Perëndisë. Ateistët na tregojnë se ne duhet të ndryshojmë sjelljet tona për të gjetur kuptimin e jetës. Por, kur Perëndia bëhet pjesë e jetëve tona, çdo gjë në jetën tonë do të ndryshojë. Do ta shikojmë ndryshe lindjen, vdekjen dhe çdo gjë që ka të bëjë me jetën e njeriut. Ndryshimet në mënyrën se si e konsiderojmë jetën do të sjellin gëzim të madh (Predikuesit 7:16–17, 21, 11:5, 8). Ateistët thonë se duhet ta anashkalojmë pyetjen për kuptimin e jetës. Por çdo njeri, herët a vonë, e kupton se nuk mund ta bëjë dot një gjë të tillë. Po ta përfshijmë Perëndinë në jetën tonë, do të shikojmë se sa e lehtë është të gjesh kuptimin e jetës: «Të dëgjojmë, pra, përfundimin e gjithë ligjëratës: “Ki frikë nga Perëndia dhe respekto urdhërimet e tij, sepse kjo është tërësia e njeriut”» (Predikuesit 12:13). Ateizmi thotë se metodat e ndryshme për të provuar kënaqësi do të sjellin kuptimin për jetën, por nuk është e vështirë të zbulosh se rendja pas kënaqësive sjell vetëm boshllëk. Po të jetojë me Perëndinë, njeriu do të provojë kënaqësitë dhe gëzimin e vërtetë që gjendet në tokë (9:7–9). Ateizmi na thotë se sukcesi do të sjellë kuptimin për jetën, por në të vërtetë ai sjell vetëm dëshpërim dhe vuajtje. Vetëm kur Perëndia të bëhet pjesë e jetëve tona, atëherë sukcesi përmban gëzim dhe qëllim të vërtetë (11:1).

KONKLuzioni

Çfarë i jep qëllim ekzistencës njerëzore? Sipas William Glasser: «Ka dy cilësi që ia shtojnë kuptimin jetës: nevoja për të dhënë dhe për të marrë dashuri

dhe nevoja për të ndjerë se ne jemi të vlefshëm për veten dhe për të tjerët.» Solomoni e sugjeroi këtë shumë kohë më përpara te libri i Predikuesit 12:13–14. Perëndia na do dhe qëllimi i jetës sonë është që ta duam dhe t'i shërbejmë Atij!

Një jetë me kuptim është një jetë me vlera të mëdha. Kjo është e mundshme për arsye të të vërtetave të mëposhtme. E para, frika ndaj Perëndisë na sjell në një marrëdhënie të drejtë me Të. Kjo «frikë» tregon respekt dhe nderim. Kjo «frikë» konfirmon akoma edhe më shumë autoritetin e Perëndisë për të udhëhequr jetën në tokë. E dyta, mbajtja e urdhërimeve të Tij na garanton një jetë më të pranueshme dhe na siguron një gëzim të madh (Psalmeve 119:97). E treta, duke iu bindur Krishtit në jetët tona, do të jemi të përgatitur për gjykimin e Perëndisë. Çdo veprim do të gjykohet nga Ati i Shenjtë. Kjo tregon se Perëndia është kaq i shqetësuar për ne sa Ai vëzhgon çdo aspekt të jetës sonë. Shqetësimi i Tij për çdo aspekt të jetës tonë thekson faktin se jetët tona kanë kuptim dhe vlerë!

Ata që e shmangin apo e mohojnë Perëndinë do të ballafaqohen me një jetë në tokë të mbushur me frikë, ku jeta s'ka vlerë dhe kuptim. Ndershmëria i detyron ta shikojnë veten e tyre si «atome të shpërbëra në një vend me baltë, të pllakosur nga vdekja dhe të përçmuar nga fati». Ateizmi duhet të ballafaqohet me «përfundimin» e librit të Predikuesit 12:13. Alternativat për ne janë të qarta: ose vargu i dytë i librit të Predikuesit (1:2): «Gjithçka është krejt e kotë...» ose çfarë shkruhet në 12:13: «Ki frikë nga Perëndia dhe respekto urdhërimet e Tij, sepse kjo është tërësia e njeriut.» Cili është qëllimi i jetës tuaj në tokë?

Autor: *John L. Kachelman, Jr.*
Marrë nga studimi: “*Perëndia kundër ateizmit*”
© 2002, 2003 E VERTETA PER SOT
Të gjitha të drejtat të rezervuara